

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE MATERIALESH TË NDRYSHME PËR
PASTRIM NDARË NË 2 (DY) LOTE”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP) **39224100-9,
33711900-6, 39224340-3**

VLERA E FONDIT LIMIT: 30,972,486 (tridhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë) **Lekë pa TVSH.**

VLERA E FONDIT LIMIT LOTIN I. “Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues”, me fond të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër: **21,735,949** (njëzetë e një milion e shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzetë e nëntë) **lekë (pa TVSH)**, ku janë përfshirë kërkesat e 6 (gjashtë) autoriteteve kontraktore.

VLERA E FONDIT LIMIT LOTIN II. “Blerje materiale të ndryshme për pastrim”, me fond të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër: **9,236,537** (nëntë milion e dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë) ku janë përfshirë kërkesat e 2 (dy) autoriteteve kontraktore

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

**Objekti: “BLERJE MATERIALESH TË NDRYSHME PËR PASTRIM NDARË NË 2
(DY) LOTE”**

Loti I. “Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues”

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros, pra 39% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar; nenin 43 pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit te këtij loti është brenda kufirit të përcaktuar ne nenin 43 pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, u përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe ligjit si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit të këtij loti, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Ky kriteri garanton Autoritetin Kontraktor se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një veprimtari ekonomike të sukseshme dhe do të realizojë me sukses kontratën objekt prokurimi.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër shërbimin e transportit të mallit

në adresat e percaktuara të AK-ve. Ky kriter është vendosur duke marrë parasysh numrin e Autoriteteve Kontraktore dhe shpërndarjen e tyre gjeografike.

3. Operatori ekonomik duhet të disponoje **1 (një) mjet për transportin e mallrave objekt prokurimi**, i cili mund të jetë në pronësi/qira/huapërdorje.

Per sa me sipër operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë të dhënat për mjetin sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Statusi
1			Pronesi/qira/perdorim

Për mjetin në pronësi duhet të paraqitet certifikata e pronësisë, ndërsa për mjetin e marrë me qira/huapërdorje duhet të paraqitet kontrata noteriale përkatëse e vlefshme.

Për mjetin në pronësi/qira/huapërdorje duhet të paraqitet edhe leje qarkullimi, akt kolaudimi (e vlefshme), sigurimin e detyrueshëm të mjeteve (e vlefshme).

Shënim 3.1: Kriteri nr.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimin. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh afatin e marreveshjes kuadër që është deri në 36 muaj sipas Autoriteteve Kontraktore kërkuese dhe shtrirjes gjeografike të tyre.

4. Operatori ekonomik, për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1
Punetore të thjeshte	1
Total	2

Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën **Mars-Prill viti 2024**.
- Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën **Mars-Prill viti 2024**.

- Leje drejtimi përkatës për shoferin.

Shenim 4.1 :

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 person me profesionin shofer, OE paraqet në staf të 1 punonjësi, që jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimit të tipit B dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Per punonjesit qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Shënim 4.2: *Kriteri nr.4 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 2 punonjësish, përkatësisht një shofer dhe një puëtorë të thjeshtë, që operatori ekonomik duhet të ketë ne dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që janë kërkuar për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi si dhe një punonjës për shkarkimin e mallrave në ambjentin e caktuar nga Autoritetet Kontraktore.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analize e lëshuar nga një laborator i akredituar nga organizma kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues (**e cila duhet të jetë origjinale ose fotokopje e noterizuar**), të njohur nga Republika e Shqipërisë, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike përsa i perket zerave të listuara mëposhtë:

- Pluhur larës lavatriçe për rroba të bardha (ambalazh qese plastike),
- Solucion enësh larës xhel

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; nenit 5 pika 1/a të ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton: a) laborator testues, mjekesor dhe kalibrues*”, si dhe Rekomandimit të përbashkët nr.3330, datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe nr.145, datë 16.03.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të produkteve që ata ofrojnë, për të cilat duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet standarde të procedurës objekt prokurimi.

6. Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues/distributor i autorizuar ose tregtuesi i autorizuar nga prodhuesi/distributori i autorizuar i mallrave për artikujt objekt prokurimi. Në rast kur OE nuk është prodhues i këtyre produkteve/artikujve, ai duhet të disponojë dhe të paraqesë: Autorizim Prodhuesi dhe/ose Kontratë Funizimi/Bashkepunimi nga një Distributor i autorizuar, në të cilat duhet të jenë përcaktuar emertimet e produkteve. Autorizimi apo kontrata duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit apo distributorit të autorizuar.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, me anë të këtij kriteri duke marrë në konsideratë llojin e produkteve dhe sasinë e tyre. Autoriteti Kontraktor kërkon të ketë siguri në mundësitë që ka operatori ekonomik për funizimin në mënyrë të vazhdueshme të produkteve cilësore dhe brenda afatit sipas kërkesave të AK-ve.

Shënim:

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapaciteti ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapaciteti teknik pika 1 seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: **18.06.2024, Ora 11:00;** Vendi: **www.app.gov.al, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, Tiranë.**

Loti II. “Blerje materiale të ndryshme për pastrim”

Shtojca 7

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”te ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros, pra 39% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” tw ndryshuar; nenin 43 pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit te këtij loti është brenda kufirit të përcaktuar ne nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, u përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe ligjit si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit të këtij loti, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Ky kriteri garanton Autoritetin Kontraktor se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një veprimtari ekonomike të sukseshme dhe do të realizojë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër shërbimin e transportit të mallit në adresat e përcaktuara të AK-ve. Ky kriter është vendosur duke marrë parasysh numrin e Autoriteteve Kontraktore dhe shpërndarjen e tyre gjeografike.

- Operatori ekonomik duhet të disponojë **1 (një) mjet për transportin** e mallrave objekt prokurimi, i cili mund të jetë në pronësi/qira/huapërdorje.
Për sa me sipër operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë të dhënat për mjetin sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Statusi
1			Pronësi/qira/perdorim

- Për mjetin në pronësi duhet të paraqitet certifikata e pronësisë, ndërsa për mjetin e marrë me qira/huapërdorje duhet të paraqitet kontrata noteriale përkatëse e vlefshme.
- Për mjetin në pronësi/qira/huapërdorje duhet të paraqitet edhe leje qarkullimi, akt kolaudimi (e vlefshme), sigurimin e detyrueshëm të mjeteve (e vlefshme).

Shënim 3.1: *Kriteri nr.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh aftin e marreveshjes kuadër që është deri në 36 muaj sipas Autoriteteve Kontraktore kërkuese dhe shtrirjs gjeografike të tyre.

- Operatori ekonomik, për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1
Punetore të thjeshta	1

Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën **Mars-Prill viti 2024**.
- Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën **Mars-Prill viti 2024**.
- Leje drejtimi përkatës për shoferin.

Shenim 4.1 :

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 person me profesionin shofer, OE paraqet në staf të 1 punonjësi, që jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimit të tipit B dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Per punonjesit qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Shënim 4.2: *Kriteri nr.4 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 2 punonjësish, përkatësisht një shofer dhe një puëtorë të thjeshtë, që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që janë kërkuar për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi si dhe një punonjës për shkarkimin e mallrave në ambjentin e caktuar nga Autoritetet Kontraktore.

Shënim:

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapaciteti ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapaciteti teknik pika 1 seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: **18.06.2024, Ora 11:00;** Vendi: **www.app.gov.al, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, Tiranë.**